

Bazuar në nenin 10 dhe nenin 15 paragrafi (3) i Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke vepruar sipas Njoftimit për dhënien e planifikuar të ndihmës dhe Njoftimit për informacione shtesë për formularin e njoftimit për ndihmën rajonale nr. 10-67 të datës 10.04.2023, i parashtruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhënëse e ndihmës shtetërore, e përfaqësuar nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial, për dhënien e ndihmës rajonale të planifikuar Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup, në seancën e mbajtur më 26.07.2023, miratoi

AKTVENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë shqyrtimit të Njoftimit për dhënien e planifikuar të ndihmës dhe Njoftimit për informacione shtesë për formularin e njoftimit për ndihmën rajonale nr. 10-67 të datës 10.04.2023, i paraqitur nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhënëse e ndihmës shtetërore, e përfaqësuar nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial, për dhënien e ndihmës rajonale të planifikuar Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup, si përfituese e ndihmës shtetërore, konstatoi se:

Masa

- **Ndihmë në vlerë prej XXX nga shuma e shpenzimeve të investimit të justifikuara të realizuara deri në datën e përfundimit, të cilat dhënësi i ndihmës shtetërore do t'i paguajë përfituesit të ndihmës shtetërore në këste, si vijon:**
 - XXX
 - XXX
 - XXX
 - XXX
 - XXX
 - XXX

përbën ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe përbën **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore. Një masë e tillë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e komponentëve elektronikë, përbën **ndihmë rajonale si ndihmë individuale sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, ku dhënia e saj është e lejuar.**

Nëse përfituesi i ndihmës shtetërore investon shuma të ndryshme nga shumat e përcaktuara në XXX këstet e lartpërmendura, ndihma shtetërore për çdo këst do të jetë XXX nga shpenzimet e investimit të justifikuara të realizuara. Nëse në periudhën nga 01.10.2029 deri në datën e përfundimit të projektit investues, përfituesi i ndihmës shtetërore investon shpenzime investimi të justifikuara deri ose mbi shumën prej XXX, përfituesi i ndihmës shtetërore ka të drejtë të paraqesë në çdo kohë kërkesë për pagesën e ndihmës shtetërore të mbetur, brenda shumës së ndihmës së përshtatur. Kjo do të realizohet në një periudhë prej 90 ditësh nga kompletimi i kërkesës.

Masa

- **Ndihmë për krijimin e vendeve të reja të punës për punonjësit me orar të plotë deri në datën e përfundimit të projektit investues, ku ndihma shtetërore për XXX**

përbën ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore dhe përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore. Një masë e tillë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e komponentëve elektronikë, përbën ndihmë rajonale si ndihmë individuale sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, ku dhënia e saj është e lejuar. Për dhënien e grantit për vendet e punës të krijuara, përfituesi i ndihmës shtetërore zotohet që paga mesatare bruto mujore bazë për punonjësit, në periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2034, të rritet me XXX.

Masa

- **Ndihmë deri në vlerën XXX nga shuma e shpenzimeve të investimit të justifikuara të realizuara deri në datën e përfundimit të projektit investues, të cilën dhënësi i ndihmës shtetërore do t'ia paguajë përfituesit të ndihmës shtetërore në këste që do të paguhen në kushte të veçanta, si vijon:**

- XXX
- XXX
- XXX
- XXX
- XXX
- XXX

përbën ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore dhe përbën **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore. Një masë e tillë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e komponentëve elektronikë, përbën **ndihmë rajonale si ndihmë individuale sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, ku dhënia e saj është e lejuar.**

Nëse përfituesi i ndihmës shtetërore investon shuma të ndryshme nga shumat e përcaktuara në gjashtë këstet e lartpërmendura, ndihma shtetërore për çdo këst do të jetë XXX nga shpenzimet e investimit të justifikuara të realizuara. Nëse në periudhën nga 01.10.2029 deri në datën e përfundimit të projektit investues, përfituesi i ndihmës shtetërore investon shpenzime investimi të justifikuara deri ose mbi shumën prej XXX, përfituesi i ndihmës shtetërore ka të drejtë të paraqesë në çdo kohë kërkesë për pagesën e ndihmës shtetërore të mbetur, brenda shumës së ndihmës së përshtatur. Kjo do të realizohet në një periudhë prej 90 ditësh nga kompletimi i kërkesës.

Në përputhje me Planin e Biznesit, përfituesi i ndihmës shtetërore do të investojë shumën e XXX si shpenzime investimi të justifikuara për projektin investues në Zonë, në periudhën deri në datën e përfundimit.

Sipas nenit 9 paragrafi (2) i Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 109/13), intensiteti i ndihmës për projektet investuese mund të jetë XXX nga intensiteti maksimal i ndihmës rajonale – për pjesën e shpenzimeve të justifikuara që tejkalojnë vlerën e denarit XXX.

Në përputhje me Projekt - Marrëveshjen për dhënien e ndihmës shtetërore Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup, në rast të një shume më të madhe të ndihmës së marrë për shpenzimet e investimit të justifikuar të konfirmuara për projektin investues, përfituesi i ndihmës shtetërore do të kthejë menjëherë dhe pa vonesë diferencën dhënësit të ndihmës shtetërore në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas Planit të Biznesit, projekti investues realizohet për qëllime të prodhimit të produkteve të reja që aktualisht nuk janë pjesë e portofolit të produkteve të palës përfituese të ndihmës shtetërore në kuadër të projekteve investuese ekzistuese të përfituesit të ndihmës shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk përbën nënprojekt të një projekti tjetër të madh investues në kuptim të nenit 9 paragrafi (3) të Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale.

Ndërmarrja për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup do të krijojë XXX vende të reja pune, duke punësuar XXX punonjës deri në datën e përfundimit të projektit investues.

Përfituesi i ndihmës shtetërore zotohet të mbajë të plotë numrin e vendeve të reja të punës për të cilat ka marrë ndihmë shtetërore në përputhje me nenin 5 të Projekt-Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup për një periudhë prej 5 vitesh duke filluar nga data e përfundimit të projektit investues.

Përfituesi i ndihmës zotohet të mirëmbajë investimin, gjegjësisht asetet (objektet, ndërtesat, pajisjet) në Zonë në gjendje produktive, operative dhe të përdorshme për një periudhë prej të paktën pesë vitesh nga data e përfundimit të projektit investues, gjë që është në përputhje me nenin 6 (1) të Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale. Nëse përfituesi i ndihmës shtetërore nuk e plotëson këtë kusht, ai është i detyruar të kthejë të gjithë shumën e ndihmës shtetërore të marrë sipas Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup së bashku me normën e interesit të llogaritur në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përfituesi i ndihmës shtetërore do të financojë të paktën 25% të shpenzimeve të investimit të justifikuar për projektin e dytë investues nga burime vetjake ose nga një palë e tretë në një formë që nuk përbën ndihmë shtetërore sipas Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore.

Arsyetim

Sipas nenit 10 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: KMK) është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme mbështetjeje, gjegjësisht nëse ajo përbën ose jo ndihmë shtetërore në kuptim të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore.

Çdo dhënës i ndihmës shtetërore, i përcaktuar në nenin 6 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, është i detyruar, sipas nenit 13 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, t'i dorëzojë KMK-së njoftim për çdo plan për dhënien e ndihmës së re ose

ndryshimin e ndihmës ekzistuese shtetërore, pavarësisht nëse ajo jepet si ndihmë individuale apo si skemë ndihme.

Duke vepruar në përputhje me detyrimin e njoftimit në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhënëse e ndihmës shtetërore, Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial dorëzoi Njoftim për dhënien e planifikuar të ndihmës dhe Njoftim për informacione shtesë për formularin e njoftimit për ndihmën rajonale për përfituesit në ZZHTI Shtip dhe ZZHTI Shkup 1, për Ndërmarrjen për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup nr. 10-67 të datës 10.04.2023 (në tekstin e mëtejshëm: njoftime), Projekt-Marrëveshje për dhënien e ndihmës shtetërore Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup (e nënshkruar), Vendim për dhënien e pëlqimit për Marrëveshjen për dhënien e ndihmës shtetërore Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup, e miratuar nga Bordi Drejtues i Drejtorisë për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial në seancën e njëqind e tridhjetë e pestë më 10.04.2023, letër qëllimi dhe plan biznesi për projektin investues të Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup nr. 13-639/2 të datës 07.04.2023.

KMK, sipas nenit 14 paragrafi (3) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, me shkresën nr. 10-67 të datës 10.05.2023 kërkoi nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial, plotësimin e njoftimit për dhënien e planifikuar të ndihmës shtetërore Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup. Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial, më 25.05.2023 me shkresën nr. 13-682/3 dorëzoi KMK-së plotësimin e njoftimit.

Gjithashtu, KMK me shkresën nr. 10-67 të datës 27.06.2023 kërkoi nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial informacione shtesë. Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial, më 03.07.2023 me shkresën nr. 13-682/5 dorëzoi KMK-së përgjigjen ndaj kërkesës për informacione shtesë.

Duke marrë parasysh faktin se njoftimet e paraqitura përmbajnë të dhënat e nevojshme për vlerësimin e ndihmës sipas nenit 14 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, dita e pranimit të njoftimit të rregullt konsiderohet 03.07.2023.

KMK brenda afatit ligjor shqyrtoi njoftimet e dorëzuara dhe Projekt-marrëveshjen për dhënien e ndihmës shtetërore Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup (e pa nënshkruar nga palët kontraktuese) dhe konstatoi gjendjen faktike si vijon:

- **Dhënësi i ndihmës shtetërore është:** Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial.
- **Përfituesi i ndihmës shtetërore është** Ndërmarrja për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup me seli në adresën Rruga Zona e Zhvillimit Teknologjik Industrial Nr. Shkup 1/BB, Ilinden Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.
- **Baza ligjore për dhënien e ndihmës shtetërore** është akti ligjor mbi bazën e të cilit jepet ndihma – Vendimi i Bordit Drejtues të Drejtorisë për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial me nr. 02-681/7 të datës 10.04.2023 për dhënien e pëlqimit për Marrëveshjen për dhënien e ndihmës shtetërore Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe

Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup dhe Projekt-Marrëveshja për dhënien e ndihmës shtetërore Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup.

Për të përcaktuar nëse një masë e ndërmarrë nga dhënësi i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore, vlerësohet nëse plotësohen në mënyrë kumulative katër kriteret e mëposhtme:

- Që një masë e tillë të përfshijë transferin e fondeve shtetërore;
- Të jetë selektive;
- Të përbëjë përfitim ekonomik për marrësin dhe
- Të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti.

Prandaj, gjatë shqyrtimit të masës së përfshirë në njoftimet e dorëzuara, KMK e analizoi atë nga aspekti nëse ajo plotësonte katër kriteret kumulative të lartpërmendura. Gjatë kësaj analize, KMK konstatoi se:

Masa: **Ndihmë në vlerë prej XXX nga shuma e shpenzimeve të investimit të justifikuar të realizuara deri në datën e përfundimit, të cilat dhënësi i ndihmës shtetërore do t'i paguajë përfituesit të ndihmës shtetërore në këste, si vijon:**

- XXX
- XXX
- XXX
- XXX
- XXX
- XXX

e parashikuar në nenin 4 të Projekt-Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore, **përbën ndihmë shtetërore**, në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore për shkak të faktit se plotëson kushtet kumulative të mëposhtme:

- Një masë e tillë përfshin transferin e fondeve shtetërore për shkak të faktit se fondet jepen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup.
- Selektiviteti i masës shihet në faktin se ndihma është e destinuar vetëm për një ndërmarrje specifike – Ndërmarrjen për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup, për shkak të së cilës prishet balanca midis ndërmarrjes dhe konkurrentëve të saj. Pra, selektiviteti i masës shihet edhe në faktin se me dhënien e ndihmës shtetërore një ndërmarrjeje, në rastin konkret – Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup, ndërmarrjet e tjera që ekzistojnë dhe veprojnë në të njëjtin treg për prodhimin e komponentëve elektronikë vihen në një pozicion të pafavorshëm. Në këtë mënyrë, me dhënien e ndihmës shtetërore për këtë masë, Ndërmarrja për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup ndodhet në një pozicion selektiv, duke marrë parasysh faktin se këto fonde mund t'i përdorë në mënyrën më të favorshme për të, me qëllim arritjen e një fitimi më të madh;
- Përfitimi ekonomik për përfituesin shihet në favorizimin e një ndërmarrjeje specifike – Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup dhe prodhimin e saj të komponentëve elektronikë, përfitim të cilin kjo ndërmarrje nuk do ta kishte në kushte normale të tregut dhe biznesit;

- Një ndihmë e tillë ka ose mund të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti. Pra, nga dhënia e kësaj mase qartë shihet se përfituesi është i përfshirë në veprimtari ekonomike dhe se do të operojë në treg ku veprojnë edhe konkurrentë të tjerë, me çka prishet ose mund të prishet konkurrenca duke mundësuar një avantazh ekonomik për ndërmarrjen specifike Ndërmarrja për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup.

KMK, përveç që konstatoi se masa e lartpërmendur përbën ndihmë shtetërore, gjithashtu konstatoi se një masë e tillë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e komponentëve elektronikë, përbën **ndihmë rajonale** sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi ajo është në përputhje me qëllimet e politikës rajonale të Republikës së Maqedonisë së Veriut **për mbështetjen e investimeve fillestare produktive ose hapjen e vendeve të punës të lidhura me investimet.**

KMK gjithashtu konstatoi se masa e lartpërmendur **përbën ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi nuk është ndihmë shtetërore e dhënë në bazë të një skeme ndihme, por është me detyrim për miratim shtesë nga KMK. KMK, gjatë vlerësimit të lejueshmërisë së dhënies së ndihmës, konstaton nëse dhënia e ndihmës bëhet sipas Rregullores për përcaktimin e kushteve dhe procedurës për dhënien e ndihmës rajonale.

Masa: Ndhimë për krijimin e vendeve të reja të punës për punonjësit me orar të plotë deri në datën e përfundimit, ku ndihma shtetërore për krijimin e XXX

e parashikuar në nenin 5 të Projekt-Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore, **përbën ndihmë shtetërore**, në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore për shkak të faktit se plotëson kushtet kumulative të mëposhtme:

- Një masë e tillë përfshin transferin e fondeve shtetërore për shkak të faktit se fondet jepen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup.
- Selektiviteti i masës shihet në faktin se ndihma është e destinuar vetëm për një ndërmarrje specifike – Ndërmarrjen për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup, për shkak të së cilës prishet balanca midis ndërmarrjes dhe konkurrentëve të saj. Pra, selektiviteti i masës shihet edhe në faktin se me dhënien e ndihmës shtetërore një ndërmarrjeje, në rastin konkret – Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup, ndërmarrjet e tjera që ekzistojnë dhe veprojnë në të njëjtin treg për prodhimin e komponentëve elektronikë vihen në një pozicion të pafavorshëm. Në këtë mënyrë, me dhënien e ndihmës shtetërore për këtë masë, Ndërmarrja për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup ndodhet në një pozicion selektiv, duke marrë parasysh faktin se këto fonde mund t'i përdorë në mënyrën më të favorshme për të, me qëllim arritjen e një fitimi më të madh;
- Përfitimi ekonomik për përfituesin shihet në favorizimin e një ndërmarrjeje specifike – Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup dhe prodhimin e saj të komponentëve elektronikë, përfitim të cilin kjo ndërmarrje nuk do ta kishte në kushte normale të tregut dhe biznesit;

- Një ndihmë e tillë ka ose mund të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti. Pra, nga dhënia e kësaj mase qartë shihet se përfituesi është i përfshirë në veprimtari ekonomike dhe se do të operojë në treg ku veprojnë edhe konkurrentë të tjerë, me çka prishet ose mund të prishet konkurrenca duke mundësuar një avantazh ekonomik për ndërmarrjen specifike – Ndërmarrjen për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup.

KMK, përveç që konstatoi se masa e lartpërmendur përbën ndihmë shtetërore, gjithashtu konstatoi se një masë e tillë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e komponentëve elektronikë, përbën **ndihmë rajonale** sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, pasi ajo është në përputhje me qëllimet e politikës rajonale të Republikës së Maqedonisë së Veriut **për mbështetjen e investimeve fillestare produktive ose hapjen e vendeve të punës të lidhura me investimet.**

KMK gjithashtu konstatoi se masa e lartpërmendur **përbën ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, pasi nuk është ndihmë shtetërore e dhënë në bazë të një skeme ndihme, por është me detyrim për miratim shtesë nga KMK.

Sipas Projekt-Marrëveshjes, për të shmangur çdo dyshim, ndihma shtetërore sipas kësaj mase është e vlefshme deri në datën në të cilën ndihma totale shtetërore do të arrijë pragun e intensitetit maksimal nga neni 9 i Projekt-Marrëveshjes.

Masa: Ndhmë deri në vlerën XXX nga shuma e shpenzimeve të investimit të justifikuar të realizuar deri në datën e përfundimit të projektit investues, të cilën dhënësi i ndihmës shtetërore do t'ia paguajë përfituesit të ndihmës shtetërore në këste që do të paguheshin në kushte të veçanta, si vijon:

- XXX
- XXX
- XXX
- XXX
- XXX
- XXX

e parashikuar në nenin 6 të Projekt-Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore, përbën **ndihmë shtetërore**, në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore për shkak të faktit se plotëson kushtet kumulative të mëposhtme:

- Një masë e tillë përfshin transferin e fondeve shtetërore për shkak të faktit se fondet jepen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup;
- Selektiviteti i masës shihet në faktin se ndihma është e destinuar vetëm për një ndërmarrje specifike – Ndërmarrjen për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup, për shkak të së cilës prishet balanca midis ndërmarrjes dhe konkurrentëve të saj. Pra, selektiviteti i masës shihet edhe në faktin se me dhënien e ndihmës shtetërore një ndërmarrjeje, në rastin konkret – Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup, ndërmarrjet e tjera që ekzistojnë dhe veprojnë në të njëjtin treg për prodhimin e komponentëve elektronikë vihen në një pozicion të pafavorshëm. Në këtë mënyrë, me dhënien e ndihmës shtetërore për këtë masë,

Ndërmarrja për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup ndodhet në një pozicion selektiv, duke marrë parasysh faktin se këto fonde mund t'i përdorë në mënyrën më të favorshme për të, me qëllim arritjen e një fitimi më të madh.

- Masa e përfitimit ekonomik për përfituesin shihet në favorizimin e një ndërmarrjeje specifike – Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup dhe prodhimin e saj të komponentëve elektronikë, përfitim të cilin kjo ndërmarrje nuk do ta kishte në kushte normale të tregut dhe biznesit.
- Një ndihmë e tillë ka ose mund të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti. Pra, nga dhënia e kësaj mase qartë shihet se përfituesi është i përfshirë në veprimtari ekonomike dhe se do të operojë në treg ku veprojnë edhe konkurrentë të tjerë, me çka prishet ose mund të prishet konkurrenca duke mundësuar një avantazh ekonomik për ndërmarrjen specifike – Ndërmarrjen për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup.

KMK, përveç që konstatoi se masa e lartpërmendur përbën ndihmë shtetërore, gjithashtu konstatoi se një masë e tillë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e komponentëve elektronikë, përbën **ndihmë rajonale** sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi ajo është në përputhje me qëllimet e politikës rajonale të Republikës së Maqedonisë së Veriut **për mbështetjen e investimeve fillestare produktive ose hapjen e vendeve të punës të lidhura me investimet.**

KMK gjithashtu konstatoi se masa e lartpërmendur përbën **ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi nuk është ndihmë shtetërore e dhënë në bazë të një skeme ndihme, por është me detyrim për miratim shtesë nga KMK.

Në Projekt-Marrëveshjen për ndihmën shtetërore është theksuar se përfituesi i ndihmës shtetërore do të krijojë XXX vende pune, duke punësuar XXX punonjës deri në datën e përfundimit të projektit investues. Përfituesi i ndihmës shtetërore zotohet që, më së vonë deri më 31 mars të çdo viti kalendarik, t'i dorëzojë dhënësit të ndihmës shtetërore një raport vjetor me një përmbledhje mujore për të gjithë punonjësit për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit paraprak deri në datën e përfundimit të projektit investues.

Përfituesi i ndihmës shtetërore zotohet që, më së vonë deri më 31 mars të çdo viti kalendarik, t'i dorëzojë dhënësit të ndihmës shtetërore një raport vjetor me një përmbledhje mujore për të gjithë punonjësit dhe pagat bruto për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit paraprak deri dhe duke përfshirë 5-vjetorin e datës së përfundimit të projektit investues. Përfituesi i ndihmës shtetërore zotohet se do të mbajë të plotë numrin e vendeve të reja të punës për të cilat ka marrë ndihmë shtetërore në përputhje me nenin 5 të Projekt-Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup për një periudhë prej 5 vitesh duke filluar nga data e përfundimit të projektit investues.

Përfituesi i ndihmës, sipas Projekt-Marrëveshjes, zotohet të mirëmbajë investimin, gjegjësisht asetet (objektet, ndërtesat, pajisjet) në gjendje produktive, operative dhe të përdorshme për një periudhë prej të paktën pesë vitesh nga data e përfundimit të projektit investues, gjë që është në përputhje me nenin 6 (1) të Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale. Nëse përfituesi i ndihmës shtetërore nuk e

plotëson këtë kusht, ai është i detyruar të kthejë të gjithë shumën e ndihmës shtetërore të marrë sipas Projekt-Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJ Shkup së bashku me interesin e llogaritur në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përfituesi i ndihmës shtetërore do të financojë të paktën 25% të shpenzimeve të investimit të justifikuara për projektin investues nga burime vetjake ose nga një palë e tretë në një formë që nuk përbën ndihmë shtetërore sipas Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore

Ndihma kumulative shtetërore do të jetë e kufizuar në shumën e përshtatur të ndihmës të llogaritur mbi shpenzimet e investimit të justifikuara të konfirmuara të realizuara deri në datën e përfundimit të projektit investues.

Sipas Planit të Biznesit, projekti investues realizohet për qëllime të prodhimit të produkteve të reja që aktualisht nuk janë pjesë e portofolit të produkteve të palës përfituese të ndihmës shtetërore në kuadër të projekteve investuese ekzistuese të palës përfituese të ndihmës shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk përbën nënprojekt të një projekti tjetër të madh investues në kuptim të nenit 9 paragrafi (3) të Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale.

KMK me Vendimin nr. 10-126 të datës 19.10.2022 miratoi dhënien e ndihmës rajonale të planifikuar Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJ Shkup me seli në ZZHTI Shkup 1 si projekt i dytë investues për prodhimin e komponentëve elektronikë, i cili i referohet investimit në asete materiale dhe jomateriale të lidhura me zgjerimin e kapaciteteve për prodhim të fabrikës ekzistuese në ZZHTI Shkup 1.

Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial, me shkresën nr. 13-682/5 të datës 03.07.2023 dorëzoi KMK-së përgjigjen ndaj kërkesës për informacione shtesë, në të cilën theksoi se projekti i dytë dhe i tretë investues i Ndërmarrjes për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KEMET ELECTRONICS MAKEDONIA SHPKNJ Shkup realizohen nga asete fikse të kombinuara në mënyrë ekonomikisht të ndashme.

Sipas nenit 9 paragrafi (1) i Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale, një projekt i madh investues konsiderohet projekt i vetëm kur investimi fillestar realizohet në një periudhë prej tre vitesh nga një ose më shumë ndërmarrje dhe përbëhet nga asete fikse të kombinuara në mënyrë **ekonomikisht të pandashme**. Gjithashtu, sipas nenit 9 paragrafi (3) i Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale, për të shmangur ndarjen e qëllimshme të projekteve të mëdha investuese në nënprojekte, çdo projekt i madh investues i realizuar në një periudhë prej tre vitesh nga e njëjta/t ndërmarrje/të që përbëhet nga asete fikse **të kombinuara në mënyrë ekonomikisht të pandashme, konsiderohet një investim i vetëm**.

KMK udhëzon që të kihet parasysh neni 9 i Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale për termin e projektit të madh investues.

Masat:

1. Lirim nga pagesa e tatimit në fitim për një periudhë prej 10 vitesh duke filluar nga dita e marrjes së Vendimit për zgjerim, në kushtet e përcaktuara me Ligjin për ZZHTI;
2. Lirim nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale mbi bazën e pagesës së pagave të punonjësve për një periudhë prej 10 vitesh duke filluar nga dita e marrjes së Vendimit për zgjerim, në kushtet e përcaktuara me Ligjin për ZZHTI;
3. Lirim nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar për importin e mallrave në zonë, me kusht që mallrat të mos jenë lëshuar në qarkullim të lirë, gjegjësisht të mos jenë të destinuara për konsum final në kushtet e përcaktuara me Ligjin për ZZHTI;
4. Lirime dhe lehtësime doganore sipas nenit 6 të Ligjit për ZZHTI;
5. Lirim nga pagesa e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore;
6. Përjashtim nga detyrimi për paraqitjen e garancisë si instrument sigurie për sigurimin e borxhit doganor që ka lindur ose mund të lindë pas përcaktimit të procedurës ose përdorimit të lejuar doganor të mallrave gjatë kryerjes së veprimtarisë në Zonë, sipas nenit 6 të Ligjit për ZZHTI

nga Projekt-marrëveshja për dhënien e ndihmës shtetërore përbëjnë dhënie të ndihmës shtetërore përmes një skeme ndihme të parashikuar në Ligjin për Zonat e Zhvillimit Teknologjik Industrial, për të cilën nuk është i nevojshëm miratimi shtesë nga KMK, duke marrë parasysh faktin se me Vendimin nr. 10-413/2 të datës 04.11.2008, KMK miratoi Ligjin për Zonat e Zhvillimit Teknologjik Industrial si skemë ndihme për dhënien e ndihmës shtetërore përfituesve të zonave të zhvillimit teknologjik industrial të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Në bazë të sipërpërmendurën, KMK vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshillë juridike: Kundrejt këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë për fillimin e një mosmarrëveshjeje administrative brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit, sipas nenit 26 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit, përveç në rast se Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës do të urdhërojë kthimin e ndihmës shtetërore të paligjshme apo të abuzuar, dhënia e së cilës nuk është e lejuar.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETAR

Prof. Dr. Владимир Наумовски